

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ergys Verdho në “rugën” e Evis Berberit, kur drejtonte ARRSH-në hapi kompani ndërtimi dhe mori tendere - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/ergys-verdho-ne-rrugen-e-evis-berberit-kur-drejtonte-arrsh-ne-hapi-kompani-ndertimi-dhe-mori-tendera/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:01:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 13:49:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	30a954e7a54b16f75cc3a375ce0ab43b3c318c6b470d850974f17f2e3dd4e86f
TEKSTI	3d820385bb05fa7ff9fd683d6fcc3139b9e3a709dff40757df1bcff9a7f7c184
PAMJA	ce22bbbf9c4df629525f24b46584018fb2f25609b5cd3cd88643d59480f6292

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ba9bf060f6d998f751d5cc7b4cd259508fbc373fe5fc1383d40aa4d11ee4480b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ba9bf060f6d998f751d5cc7b4cd259508fbc373fe5fc1383d40aa4d11ee4480b>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Ergys Verdho në “rrugën” e Evis Berberit, kur drejtonte ARRSH-në hapi kompani ndërtimi dhe mori tendera

by Lajm Lajm — September 23, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Disa drejtorë dhe ish-drejtorë të Autoritetit Rrugor Shqiptar janë arrestuar, hetuar, gjykuar e dënuar për abuzime të shumta me detyrën, duke i shkaktuar arkave të shtetit dëme shumë të mëdha.

Me apo pa dashje, telefoni i ish-drejtorit **Evis Berberi** ka zbuluar prova të shumta për Prokurorinë e Posaçme, prova që vijnë të dalin, duke implikuar një mori zyrtarësh që paracaktonin tenderat me shumë zero.

Nëse Berberi, Balluku, Gjyli e Elezi janë marrë të pandehur, një ish-drejtor po vijon të kacafytet nga njëra anë në tjetrën, duke tentuar që t'i shpëtojë “kthetrave” të drejtësisë, pavarësisht se ka një “mal” me prova që e implikojnë në shumë procedura. Bëhet fjalë për **Ergys Verdhon**, aktualisht drejtor i Përgjithshëm i Hekurudhës Shqiptarë, ndërkohë më parë ka drejtuar Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare.

Verdho u katapultua nga bizneset private në majën e institucioneve me shumë lekë, madje ai është një nga njerëzit më të besuar të ish-zv.kryeministres, pasi në të gjitha emërimet që i janë bërë “bekimin” dhe urdhrin e ka dhënë Belinda Balluku. Vox News ka analizuar disa dokumente nga Qendra Kombëtare e Biznesit, tendera, akte noteriale e vendimmarrje të tjera, disa prej të cilave do të flasim në vijim, të cilat hedhin dritë se Verdho ka të njëjta veprime si Berberi.

Për kujtesë, ish-drejtori i ARRSH-së, Evis Berberi, është nën akuzë dhe i arrestuar, ku një nga episodet lidhet me favorizimin e ish-firmës së tij, në disa procedura tenderuese. Ndërkohë që Verdho është treguar pak më dinak, pasi ai nuk i dha tendera firmës së tij, por i mori nga “shokët” apo pasardhësit e tij në detyrë. Gjatë kohës që u emërua drejtor i ARRSH-së, hapi kompani projektimi dhe ndërtimi, ku kishte në pronësi 50 % të aksioneve të kompanisë “V&CE studio”.

STATUTI

“V & CE STUDIO” SH.P.K

Në këtë statut
- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I

TË FUNDIT

Thirrja e Gent Prognit për qytetarët: Nesër në 09:00 te Kuvendi, dilni për familjen tuaj. Nëse jemi shumë, do ju dridhen këmbët

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet Shpëtim Aliu në Rusi, një nga “kokat” e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

SEPTEMBER 23, 2026

Ambasadorja e BE takohet me kryetaren e KLP: Një sistem i fortë drejtësie është thelbësor për të ardhmen e Shqipërisë

SEPTEMBER 23, 2026

Pankartat ironizuese: “Nga Belinda te SHISH-i, krejt ekipi në pranga! Jep dorëheqjen Edi Rama, nuk të shpëton dot as banda

SEPTEMBER 23, 2026

Edison Lika: Qëndresa çdo ditë në shesh po gërren pushtetin e qeverisë, kryeministri do të bjerë si tigër prej letre

SEPTEMBER 23, 2026

Aktivistja i këndon këngë deputetes së PS: Zegjine o Zegjine, ti nuk di të numërosh, shko në shkollë të mësoh! Plas debati

SEPTEMBER 23, 2026

“Shqipëria kërkon revolucion”/ Sot dita e 116-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet polici në Klos, dyshohet se ushtroi dhunë ndaj një vajze dhe vëllait të mitur të saj

SEPTEMBER 23, 2026

Berisha: Balluku ka vjedhur miliona euro, ndërsa Lubia e SHISH sigurinë kombëtare! Qeveria ka marrë goditjen më të rëndë

SEPTEMBER 23, 2026

Gazetari trondit me deklaratën: Dyshime të forta për lidhjen e Neritan Nallbatit me Ergys Agasin

SEPTEMBER 23, 2026

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 30/10/2019 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "V & CE STUDIO" sh.p.k. Themeluesit e shoqërisë janë :

1. Z. Ndrichim Allkaj, shtetas shqiptar, lindur në Grahesh, më datë 13/02/1975, identifikuar me pasaportë nr. BG898 dhe numër personal H502, i biri i Dilaverit, banues në adresën: Rruga "Kongresi i Mandistrit", Tiranë, zotëruar i 50% të kapitalit të shoqërisë.
2. Z. Ergys Verdho, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më datë 01/05/1974, identifikuar me kartë identiteti nr. 0291 dhe numër personal H405, i biri i Nikollës, banues në adresën: Rruga "Elbasanit", Tiranë, zotëruar i 50% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Vlerësim i pasurive të paluajtshme. Projektim në fushën e ndërtimit.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

Faksimile: Akti i themelimit të kompanisë "V&CE studio", dikur në pronësi 50 % të Ergys Verdhos

Vox News ka mësuar se Verdho u emërua si punonjës në ARRSH-së në vitin 2018, fillimisht duke mbajtur pozicionin e nëndrejtorit. Më pas, në tetor të vitit 2019, u emërua si drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rugor Shqiptar.

Sipas dokumenteve që ka hulumtuar Vox News, në momentin që mori detyrën e drejtorit të ARRSH-së, Ergys Verdho çuditërisht regjistroi në Qendrën Kombëtare të Biznesit një kompani, të quajtur "V&CE Studio", ku Verdho kishte 50 % të aksioneve dhe 50 % i kishte Ndrichim Allkaj. Firma ka si objekt "vlerësim i pasurive të paluajtshme, projektim në fushën e ndërtimit".

Pra, një zyrtar i lartë shtetëror i futet me "kokë" biznesit, në një kohë që ligji e përcakton qartë konfliktin e interesit. Ka dyshime se gjatë kësaj kohe, shumë kompani që Verdho u jepte tendera me shumë zero, kontraktin fikтивisht këtë firmë, ndërkohë që hetimet e Prokurorisë së Posaçme apo të ndonjë organi tjetër ligjzbatues mund të hedhin dritë mbi këtë aferë.

Faksimile: Verdho e shiti firmën në nëntor të vitit 2020, në vlerën e 5 mijë lekëve

Dokumentet e tjera të hulumtuara nga Vox News hedhin dritë mbi një dosje të mirëfilltë, pasi ish-drejtori i ARRSH-së dhe aktualisht drejtor i Përgjithshëm i Hekurudhave, dyshohet se ka favorizuar firmën ku ishte pronar për t'u bërë presion firmave të ndërtimit.

Sipas dokumentit të mësipërm, në datën 24 nëntor 2020, Ergys Verdho i ka lënë me letra aksionet prej 50 % në firmën "V&CE Studio", duke ia kaluar aksionerit tjetër Ndrichim Allkaj. Vlera e transaksionit është vetëm 5 mijë lekë, çka ngre dyshime të mëdha për veprime fiktime. /VoxNews

Tags: ARRSH Ergys Verdho kompani ndërtimi tendera

Previous Post

Përshkallëzohet bojkoti i avokatëve/ Nuk marrin pjesë as në seancat për masat e

Next Post

VIDEO/ Mbetet kritike situata nga zjarri mbi Spitalin e Vlorës



Lajm Lajm

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja
mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Është studente ekselente, e birësuar nga një çift grek / Trondit avokati: Bleona Mata është gjallë

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë

0 SHARES